



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.367, Datë 13.11.2023

PËR

“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR  
PROKURORIN ANILA LEKA”

Bazuar në nenet 143, 149/a, *germa “e”*, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, *germa “a”* të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Anila Leka, si lektore për lëndën “Legjislacion mjedisor dhe mekanizmat detyrues për zbatim në mbrojtjen e mjedisit”, në Shkollën e Magjistraturës, në semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024.
2. Të njoftohen për këtë vendim zonja Anila Leka dhe Prokurori i Përgjithshëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 13.11.2023.

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

